



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .08.2026

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga z. T.A.
Adresë njoftimi: Av. N.M. Bld “Dëshmorët e Kombit”

TIRANË

I nderuar z. A.!

Në përgjigje të kërkesës tuaj drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti), me tonën nr. 1747 prot., datë 07.08.2026, ku kërkon “një kopje të *“Arkiva e Autoritetit Fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, Dosje e Objektit të Rëndësisë së Veçantë nr. 71, Ndërmarrja Gjeofizike Patos, me 183 (njëqind e tetëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1970-1991. Tipi i Objektit Ekonomik. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”, dokumentacion i cili është deklasifikuar me nr. 165 sipas Bibliografia e informacionit të Deklasifikuar në AIDSSH nr. 86, prot. datë 20.11.2023”, informacion i nevojshëm për çështjen ku është palë në konfliktin administrativ me palë Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier dhe ISSH për shkak të mosnjohjes së profesionit të axhustatorit si profesion që përfshihet në industrinë e naftës dhe të gazit, me pasojë refuzimin e përfitimit të trajtimit financiar suplementar sipas ligjit nr. 29/2019...*”, Ju informojmë se :

Nga shqyrtimi i kërkesës, vërehet se aksesimi në dokumentacionin nënshtror të dispozitave të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, dhe **jo dispozitave të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”**.

Ligji nr. 45/2015, që normon veprimtarinë funksionale të Autoritetit, gjen zbatim në këtë pikë duke prevaluar mbi ligjin nr. 119/2014, pasi **dokumentacioni që kërkohet për vënien në dispozicion lidhet me vënien në dispozicion të të dhënave të fondit arkivor procesi i cili kryhet në përputhje me rregullat dhe procedurat ligjore që kërkojnë dispozitat specifike të ligjit nr. 45/2015.**

Sa më sipër, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, ligjit nr. 45/2015, ju rekomandojmë të plotësoni Formularin për Aplikim nga Individët në çdo rubrikë, të miratuar nga Autoriteti për shqyrtimin dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit arkivor sipas objektit, i cili pas dërgimit do të adresohet dhe përcillet për kompetencë pranë strukturave përkatëse të institucionit për shqyrtim e ndjekje. Ky Formular gjendet edhe në faqen zyrtare të Autoritetit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit
L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sofi Noti

Konceptoi: L. Cocoli
Datë: 17.08.2026

Adresa: Njësia Administrative nr. 4
Rruga Kongresi i Manastirit, Garnizoni “Skënderbej”, Tiranë

www.autoritetidosjeve.gov.al
email:info@autoritetidosjeve.gov.al